



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.06.2018, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit të datës 04.06.2018.
2. Miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 11 qershor – 06 korrik 2018.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e korigjimit të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për huan e politikës së zhvillimit të sektorit financiar”. (*Komision për dhënie mendimi*)
4. Miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2017”.

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Enkelejd Alibeaj, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Spartak Braho, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi Tyli, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka, Elena Xhina, Luçiano Boçi.

**Mungon:** Tom Doshi

#### **Të ftuar:**

Erjon Luçi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Tedi Bushaj – Specialist në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

## HAPET MBLEDHJA

**Ulsi Manja** – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi formohet, kështu që vazhdojmë me rendin e ditës.

Pikë të parë kemi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së komisionit të datës 04.06.2018. Deputetët e kanë marrë procesverbalin e mbledhjes nëpërmjet postës elektronike. A ka vërejtje për procesverbalin? Nuk ka.

Miratohet procesverbali i mbledhjes së datës 04.06.2018 të Komisionit të Ligjeve.

Vazhdojmë me pikën e dytë: miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 11 qershor - 06 korrik 2018. Kalendarit i punimeve të komisionit, sipas Rregullores, është bërë mbi bazën e kalendarit të miratuar në Kuvendin e Shqipërisë. A ka vërejtje për kalendarin e punimeve të komisionit për periudhën 11 qershor - 06 korrik 2018?

Po, zoti Alibeaj, për kalendarin.

**Enkelejd Alibeaj** – Faleminderit, zoti kryetar!

Sigurisht, një nga çështjet kryesore, e cila do të duhet të diskutohet në seancë, por edhe në komision është çështja e kalendarit. Nuk bëhet fjalë vetëm për ato të cilat do të duhet të jenë ligjet apo vendimet që ky komision do të duhet të shqyrtojë, por, mbi të gjitha, është përcaktimi i prioriteteve që do të duhet të ketë Kuvendi, organi qeverisës më i lartë i shqiptarëve, dhe Komisioni i Ligjeve, një prej komisioneve më të rëndësishme, i cili do të duhet të diskutojë dhe të artikulojë, ndoshta, linjat kryesore politike të vendit. Unë e shoh kalendarin që keni propozuar ju (besoj se ka një kalendar edhe më të rëndësishëm se ky) që u bishton çështjeve kryesore politike që kanë sensibilitet publik, të cilat shqetësojnë shqiptarët, ndërkombëtarët dhe të gjithë opinionin, por të vetmin që nuk e shqetësojnë është Kryeministri i vendit. Këtu e kam fjalën që në kalendarin e punimeve të këtij Kuvendi nuk ka çështje të dytë, përveç asaj që ka të bëjë me përcaktimin e sforcave të angazhimit, të mobilizimit të pushtetit, sigurisht edhe të opozitës, lidhur me atë që është pikësnyimi kryesor i Shqipërisë në këtë kohë, që është kryerja e akteve politike, dhe jo vetëm, në funksion të çeljes së negociatave. Ky është dhe ky duhet të jetë preokupimi kryesor i këtij Kuvendi.

Në fakt, sot ju na propozoni një kalendar veprimtarish, që është i kithët fare me këtë shqetësim të ndërkombëtareve, me këtë shqetësim të opinionit publik shqiptar. Për këtë arsye,

besoj se në këtë seancë, si dhe në çdo seancë tjetër, si ato që janë kryer dhe ato që do të kryhen deri më 28 qershor kur Këshilli i Europës do të duhet të thotë fjalën e tij për ngjarjen më të madhe historike, e cila përcakton trajektoren e historisë politike të këtij vendi dhe jo vetëm për atë që kaluar, por edhe për atë që do të vijë, kjo do të duhet të jetë pika e vetme e diskutimit. Në fakt...

**Ulsi Manja – Po...**

**Enkelejd Alibeaj – Të lutem, mos më ndërprit!**

Në fakt, kjo është një thirrje që, së pari, u bëhet kolegëve të Komisionit të Ligjeve, për sa kohë që besohet se ndonjëri nga ju nuk ka ndonjë axhendë të ndryshme nga ajo e çeljes së negociatave, pra ndonjë axhendë personale, si ajo e Kryeministrit. Unë kuptoj që, ndoshta, pesha juaj politike në përcaktimin e formulimeve të prioriteteve politike brenda maxhorancës suaj mund të mos jetë e rëndësishme, por, mbi të gjitha, siç jua kemi thënë edhe më parë, gjithsecili prej jush ka një angazhim politik personal, ka një dinjitet personal, mbi të cilin do të duhet të lërë mënjanë çfarëdolloj shmangieje, devijimi nga kjo axhendë kryesore e shqiptarëve. Në fund të fundit, kur jemi zgjedhur deputetë dhe kur kemi vënë dorën mbi Kushtetutë, gjëja e parë që kemi thënë është: t'i shërbejmë interesit publik, interesit të shqiptarëve. Ju nuk po e bëni këtë. Më vjen keq t'ju them se jeni duke u përdorur pikërisht nga axhenda e Kryeministrit, në pikat e së cilës nuk gjendet ajo që është më kryesorja, si e si të kryejmë veprime, sforco dhe akte politike në funksion të çeljes së negociatave. Kjo ndodh sepse ai është i zënë me çështje të tjera. Axhendën e vet e ka të mbushur me çfarëdolloj pike tjetër, pra me një angazhim politik dhe institucional total të ndryshëm, që nuk ka fare qasje me shqetësimin e publikut shqiptar. Angazhimi i opozitës është bërë i qartë jo këto dy-tri javë, por shumë kohë më parë. Kjo opozitë është e vendosur qartazi dhe i ka qëndruar në mënyrë konsistente pikërisht dhënies së kontributit për çeljen e negociatave, si një lloj vlerësimi, që duhet ta miratojë historia politike e këtij vendi, fatkeqësisht, dhe këtë e kemi thënë edhe me zë të lartë, ne jemi shumë të qartë në pozicionin tonë politik. Ky vend meriton çeljen e negociatave. Jo thjesht se ka arritje, por për një arsye tjetër, si e si që një dorë tjetër e fortë, e sinqertë, dhe institucionale t'ia mbyllë një orë e më parë arbitraritetin këtij Kryeministri, mundësisht deligjitimitimin e tij dhe largimin e tij një orë e më parë. Ne besojmë se inspirimi europian i opozitës dhe i të gjithë shqiptarëve do të duhet të jetë mjeti i vetëm kryesor që do të duhet të na udhëheqë në kohë të mira, por edhe në të keqja, si këto që po kalojnë tani. Nuk ka nevojë më të madhe për Shqipërinë dhe shqiptarët, për të shkuarën dhe sidomos për të ardhmen, që të gjejnë aleatë besnikë dhe fanatikë, që ia duan të mirën këtij vendi, për të larguar të keqen më të madhe, Kryeministrin

Edi Rama, icili në axhendën e vet politike nuk e ka këtë gjë, por ka thjesht dhe vetëm një axhendë, ruajtjen e karriges së vet me çdo mjet, me çdo mënyrë dhe me çdo pazar të mundshëm që është duke zhvilluar.

Ne kemi qenë konsistentë, siç jua kemi thënë edhe më parë, do t'jua themi sot, do t'jua themi edhe më vonë, siç jua thamë edhe më 26 maj në protestën që bënë shqiptarët, në të njëjtën në linjë me ne këto kohë, të cilat po ikin me shpejtësi. Sot është 11 qershor, edhe dy javë është hapësira, për të cilën ju dhe bashkë me ju edhe Kryeministri juaj ka mundësi, se e di që s'ka dëshirë, për t'i kryer këto veprime dhe për të dhënë prova të forta, energjike dhe të sinqerta që do të çelen negociatat.

A e mbani mend para 3 javësh kur doli rekomandimi?! Gjëja më e madhe dhe më e fortë që thoshte ishte: "U dha rekomandimi pa kushte, si kurrë më parë". Ishte ai që thoshte me të madhe këtë historinë e vetingut, madje numëronte vendimet që kishin dhënë organet e vetingut, 17 vendime, 19, 21 dhe, dukej sikur vetëm ai ishte preokupimi kryesor. A e dëgjon njeri të flasë sot për vetingun? A e dëgjon njeri të flasë sot për reformën në drejtësi? A e dëgjon njeri sot të ngrefoset për arritjet e tij të mëdha? Askush! Që do të thotë se ka devijuar menjëherë nga qëndrimi i vet hipokrit i deridjeshëm dhe sot po del fytyra e vërtetë e këtij njeriu, e cila duket në disa dimensione. Dimensioni i parë që na përket neve, juve më shumë, por edhe të gjithëve bashkë anëtarë të Komisionit të Ligjeve është reforma në drejtësi, që shkatërroi sistemin e drejtësisë; reforma në drejtësi, që me duart tona shkatërruam Gjykatën Kushtetuese, me sa duket, njëherë e përgjithmonë; reforma në drejtësi, që shkatërroi Gjykatën e Lartë me 25 mijë dosje. Klotilda, Vasilika, Adnor, ju e kuptoni shumë mirë se çfarë do të thotë kjo. Sot në Gjykatën e Lartë janë të depozituara 25 mijë dosje dhe askush nuk i prek; reformë në drejtësi me një prokurori, e cila ka marrë fund...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Akoma më keq, që do të thotë se reforma në drejtësi sot i ka prerë krahët, i ka prerë shpresën çdo shqiptari për ta gjetur të drejtën e vet në Gjykatën Kushtetuese, në Gjykatën e Lartë, në prokurori dhe në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Kjo është një nga dramat më të mëdha që i ka ndodhur këtij vendit. Kjo nuk është reformë në drejtësi, por shkatërrim i drejtësisë.

Ju e kuptoni shumë mirë se çfarë do të thotë për një europian një republikë, të cilës i ka rënë totalisht njëra këmbë e pushtetit, këmba më e rëndësishme, ajo që e mban e pushtetin, sepse qeveritë vijnë dhe ikin, parlamentet vijnë dhe ikin, deputetët vijnë, ikin dhe nuk kthehen ndonjëherë, por sistemi i drejtësisë është ai që do të duhet të rrijë. Jo, ai është shkatërruar i pari me

një arsye fare të thjeshtë, që ajo qeveri dhe ai Kryeministër, i cili duhet të ikë një orë e më parë, të vazhdojë dhe ta mbajë mbërthyer karrigen e vet. Ky, Edi Rama, sakrificën më të madhe e ka bërë me sistemin e drejtësisë.

Së dyti, po e mbani mend se çfarë thoshte bashkë me vetingun, pra se si kishte bërë ç' ishte e mundur për çështjen më të madhe deri në ato momente, atë të Saimir Tahirit, të cilën e orkestroi aq bukur, sa e dorëzoi deri në arrest në shtëpie ish-ministrin e vet kampion, atë që kanabizoi dhe mbolli krimin në këtë vend. Në momentin kur duhej të kishte korrur frytet e fitores së vet, ish-ministri i Brendshëm, njeriu më i anatemuar, ai i cili sintetizonte politikën qeveritare të këtij vendi, kampioni në kanabizim dhe në krim, doli i lirë si prova e parë e dështimit madhështor të sistemit të ri të drejtësisë, tashmë i kapur nga Kryeministri, por nga ana tjetër, kuksianët vazhdojnë të jenë ende burg, edhe të sëmurë. Kjo ishte prova e dytë, akoma më e rëndë, e një drejtësie, e cila është luks për ish-ministra apo për ministra, por është thundër dhe diktaturë për njerëzit e thjeshtë. Për të parët, të cilët mbushin xhepat, ligji nuk vepron, por këtyre xhepushuarve të varfër dhe në mjerim u dhurohet edhe burgu, edhe vetëvrasja, siç ndodhi në Shkodër, apo edhe vrasja, siç ndodhi në Korçë. Pra, kjo është agjenda e Kryeministrit.

E kuptoj që nuk ishte më histori rekomandimesh pa kushte. Kushtet ishin të shumta, të thëna prej një viti e gjysmë nga përfaqësuesit gjermanë, të përforcuara edhe nga përfaqësuesit e vendeve të tjera, që, çuditërisht, janë gjithnjë e më skeptik për këtë vend. Vetëm sytë e Kryeministrit nuk e shihnin këtë lloj skepticizmi, nuk i shihnin këto kushte. Tashmë ia kanë thënë. Në momentin kur kuptoi se është një fabul politike, e cila nuk ecën më, u demaskua, doli i lirë në çështjen penale akoma dhe më të rëndë, atë të Fatmir Xhafajt, i kapur gafil në më shumë se disa episode, i kapur gafil në mbrojtjen e vëllait të tij të dënuar, që bariste i lirë në Shqipëri, i dënuar në Itali me 7 vjet e dy muaj burg, aq i sigurt, sa në momentin kur u kap me presh në duar, e nisën dhe e degdisën.

Jo vetëm kaq, por dëshmitarit fakir x, i vendosën të gjithë shtetin kundër, me policinë, me prokurorinë e Tiranës, me Prokurorinë e Krimeve të Rënda, me Forcat Speciale, që survejojnë opozitën. Aq panik e ka kapur atë, sa është gjithmonë me idenë se ç'po ndodh, se ç'po del ndonjë gjë tjetër. Në fakt, nuk ka sy që ta kuptojë se nuk ka nevojë t'i nxjerrë opozita skandalet e mëdha të kësaj qeverie, sepse ato janë në sytë e të gjithë shqiptarëve. Paniku e ka çuar deri në atë pikë, sa jo vetëm e mbërtheu prokurorinë që më 18 dhjetor, jo vetëm vazhdoi ta mbërthejë me kapjen e Prokurorisë së Krimeve të Rënda apo të prokurorëve të tjerë, apo me presionin që ushtron ndaj

prokurorëve të çështjes me vetingun, por tashmë i ka drejtuar të gjitha forcat e veta vetëm e vetëm për të shkatërruar këtë proces penal: intimidu dëshmitarë, josh dëshmitarë, shpik prova, nxirr audiopërgjimin si joautentik. I servir prokurorisë dhe gjykatës vendimin e gjykatës, vendimin e tij, duke i thënë: “Mos lëviz asnjë presje nga vendimi që duhet të japësh, se, përndryshe, spata e vetingut do të qëndrojë mbi kokën tënde”. Kështu po ndodh në këtë rast. Madje, shpik edhe dëshmitarë të blerë. Kjo është akoma dhe më qesharake, se, siç duket, nuk ka parë gjë akoma në të gjithë këtë histori. Pra, kjo është agjenda e Kryeministrit.

Dhe jo vetëm kaq. Kaq i demaskuar është Kryeministri, tashmë 2 javë mbas momentit më historik që ka ky vend, sa fillon dhe bën pazar me Shqipërinë dhe me shqiptarët. E nisi këtë histori në fillim të mandatit të tij të parë. I mbani mend armët kimike, apo jo? Njeriu, i cili u vetofrua në atë kohë, e pa fundin. Të njëjtën gjë, të njëjtën histori, është duke bërë edhe në këto momente.

Mediet, jashtë dhe brenda, si dhe përfaqësues të lartë, po thonë se ky njeri ka vendosur që këtë vend ta kthejë në një kamp refugjatësh, ku 80 mijë shqiptarë, që e duan këtë vend, u detyruan të iknin, në një vend ku siguria është zero, ku krerët e policisë virtytin e vetëm që kanë, është si të bashkëpunojnë me krimin, ku gomonet e transportit të drogës...

**Ulsi Manja** – Mund ta përmbyllni, se do të flasim edhe kolegët e tjerë.

**Enkelejd Alibeaj** – Të lutem, mos më ndërprit!

...janë ende të gatshme dhe të ngrohta për të filluar transportin e të mjerëve refugjatë.

*(Ndërhyje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Të lutem, se është një skenar tjetër sot! Do të mbarojë ky dhe do të vazhdojmë ne.

**Enkelejd Alibeaj** – Pa merak, do të vazhdosh më vonë.

*(Ndërhyje pa mikrofon)*

Unë e kuptoj, juve ju dhemb veshi, por mirë është t’u bëni shërbim atyre që ju kanë zgjedhur, atyre...

*(Ndërhyje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** - Ju lutem, do të flasim të gjithë!

**Enkelejd Alibeaj** – Ju lutem!

Pra, kjo është historia e agjendës. Po bën pazar të pistë me Shqipërinë dhe shqiptarët, për menderen e vet, për karrigen e vet. E kuptoni? Prandaj, agjenda e tij nuk është më si të ndërtojmë shtetin, si të bëjmë reformën në drejtësi, si të japim provat energjike, që na i kërkojnë partnerët,

siç i kërkuan të jepte prova që drejtësia të vepronte mbi Saimir Tahirin dhe Fatmirin. Jo. Tashmë i ka dalë...

*(Ndërhyje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem!

**Enkelejd Alibeaj** – Alket, vetëm ti mos fol, sepse ti ke edhe disa gjëra të tjera në këtë histori, por nuk ka ardhur akoma koha!

**Ulsi Manja** – Ju lutem, zoti Alibeaj, lërimi konsideratat personale!

**Enkelejd Alibeaj** – Pra, kjo është agjenda e Kryeministrit. Dhe çfarë bën Kryeministri?

*(Ndërhyje pa mikrofon)*

Mirë, mirë.

**Ulsi Manja** – Zoti Hyseni, të lutem, mos...!

*(Ndërhyje pa mikrofon)*

**Enkelejd Alibeaj** – Kjo është agjenda e Kryeministrit, një Kryeministër, i cili ka lënë çdo interes publik dhe vazhdon thjesht dhe vetëm, si një taleban i vërtetë politik, të mbrojë karrigen e vet, duke shitur çdo gjë vetëm për karrigen e vet. Dhe si për t'i vënë edhe qershinë mbi tortë, i këput një të prishur Teatrit Kombëtar. Ujk që qimen e ndërron, por zakonin nuk e harron. Në të gjithë këtë zallamahi të madhe, ku çështja e vetme që diskutohet është se si ky shtet të vijë era shtet për të çelur negociatat, huqin e ka te vjedhja: prish teatër, për të vjedhur toka; prish teatër, për të mbjellë kulla. Ky është Kryeministri i shqiptarëve!

Në fakt, ajo që është çështja e katërt, që do të duhet ta dëgjojmë të gjithë, kush ka sy e veshë, është të shihnim edhe një herë se cila është qasja dhe qëndrimi i shqiptarëve. E keni parë se si i mbath nga njëri qytet në qytetin tjetër, se shqiptarët i dalin përditë dhe, më në fund, kanë fituar kurajën për t'i treguar vërtet se cili është. E patë në Elbasan, në Lushnje, në Fier, se si me bisht ndër shalë ikën prej shqiptarëve, ikën prej atyre njerëzve që kërkojnë vetëm një gjë: të largojë krimin, nëse mundet, të largojë korrupsionin, të qeverisë, nëse do dhe nëse mundet.

Kjo është axhenda që duhet të kemi të gjithë ne. Mos jini fare të kompleksuar! Është një pikë kaq e rëndësishme historike sa përcakton politikën e këtij vendi, të 27 apo dhe më shumë vjetëve që do të vijjnë, dhe kërkon nga gjithsecili prej jush, që, minimalisht, një herë në jetën tuaj politike, të dalë mbi këtë lloj kompleksi politik ku ai ju ka futur. Ai nuk ju do, ju jo që jo, por nuk do as Shqipërinë dhe as shqiptarët, që të provojë apo të tregojë sinjale të forta se është për çeljen

e negociatave. Ndëshkimi që do të vijë do të jetë kaq i rëndë jo vetëm për atë, se ai nuk e do, por do të vijë edhe për shqiptarët. Ne duhet t'ua kursejmë shqiptarëve këtë gjë.

Kjo është ajo që doja të thosha për projektin e punës dhe veprimtarisë së këtij parlamenti.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Alibeaj!

Ju lutem, sipas nenit 29 të Rregullores, Komisioni i Ligjeve e harton kalendarin e punimeve, duke mbajtur parasysh programin e punës dhe kalendarin e punimeve të Kuvendit i miratuar në seancë plenare dhe, nëse nga kolegët e opozitës ka vërejtje për kalendarin e punimeve të komisionit, ato do të duhej t'i kishin ngritur në seancë plenare, kur u miratua kalendari i punimeve të Kuvendit.

**Oerd Bylykbashi** – Zoti kryetar, e kam për procedurë.

**Ulsi Manja** – E hedhin në votim.

Kush është dakord me miratimin e kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 11 qershor-16 korrik?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kalendarin jo, se kemi rend dite tjetër. Prioritetet i përcakton maxhoranca dhe jo opozita.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Zonja Hysi për procedurë.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

**Ulsi Manja** – Zonja Hysi, e keni kërkuar fjalën për procedurë, prandaj mos më riktheni aty ku ngritëm duart, se kalendari u miratua.

**Enkelejd Alibeaj** – Po them për kalendarin që duhet të kemi ta gjithë këtu.

**Ulsi Manja** – Kini respekt për kolegen! Ju vërtet keni fjalën e lirë, por jo t'i shpërdoroni.

Zonja Hysi, mund të vazhdoni!

**Enkelejd Alibeaj** – Ne kemi fjalën e lirë dhe kërkojmë të respektohet procedura dhe kalendari i punimeve.

**Ulsi Manja** – Nenet 29 dhe 31 të Rregullores janë shumë të qarta dhe mund ta lexoni.

**Enkelejd Alibeaj** – Gjithsecili prej anëtarëve të komisionit duhet të thotë fjalën e vet. Zoti Bylykbashi e ka kërkuar fjalën për kalendarin.

**Vasilika Hysi** – Zoti Alibeaj, ju dëgjova dhe nuk ndërhyra, unë e kam kërkuar fjalën për procedurë para jush, por në respekt të opozitës, fjala ju dha juve.



Zoti kryetar, kam tri çështje nga pikëpamja procedurale.

E para, ne deputetët nuk mbajmë përgjegjësi për çfarë themi, por mbajmë përgjegjësi për keqinformimin, apo informacionin e rremë që përhapim, sepse sot qytetarët, nëpërmjet fjalës së kolegut Alibeaj, nuk arritën të marrin informacionin e saktë të kalendarit të Komisionit të Ligjeve, që adreson 4 çështje të rëndësishme dhe që janë parësore: vazhdimin e reformës në drejtësi, problemet që lidhen në monitorimin e institucioneve të pavarura si: Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mosdiskriminim, ligji i rëndësishëm i cili mbron gratë dhe vajzat nga dhuna në familje dhe, e fundit fare, llogaridhënia që duhet të japë qeveria lidhur me zbatimin e politikës penale. Të gjitha janë pjesë të kalendarit dhe duhet t'ia bëjmë të qartë publikut, si dhe ta ftojme të jetë pjesë e konsultimit publik në procesin e vendimmarrjes.

E dyta, zoti kryetar, do të doja, që, të paktën ne të Komisionit të Ligjeve, të cilët kemi qenë pjesë e grupit të punës, të zbatohet Kodi i Etikës dhe i komunikimit të deputetëve jo vetëm në këtë komision, por në të gjitha komisionet.

E treta, në kuadër të procedurës parlamentare që këtë kalendar, i cili mbart çështje shumë të rëndësishme, siç është ligji “Për avokatinë”, ligji “Për Policinë Gjyqësore”, ligji “Për ndryshimet në ligjin “Për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve””, nismën tuaj dhe të zonjës Bushka, si dhe ligjin “Për shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për parandalimin e dhunës në marrëdhëniet familjare””, të përfitojmë nga rasti dhe të ftojme të gjitha organizatat e shoqërisë civile, për t'i bërë pjesë të konsultimit publik për ligjin e fundit. Nga ana tjetër do të ftoja kolegët e opozitës, meqenëse këto janë ligje të reformës në drejtësi dhe janë shumë të rëndësishme për data 28 qershor, të vijnë dhe të punojmë bashkë për miratimin e tyre.

**Oerd Bylykbashi** – Akoma beson ti te reforma në drejtësi që ke bërë?

**Ulsi Manja**– Ju lutem, zoti Bylykbashi, sipas Rregullores fjala është një këtej e një këtej. Zoti Alibeaj foli, pastaj e kërkoi zonja Hysi. Tani po e kërkoni ju fjalën për procedurë, sapo të mbaroni ne do të vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës.

**Oerd Bylykbashi** – Zoti kryetar, tani që të miratosh kalendar thjesht për të mbushur mbledhjet e komisionit, tregon hall.

Zoti Manja, a ka mundësi?

Sa herë ka pasur një moment të rëndësishëm: integrimin në BE të Shqipërisë, kur ne kemi qenë në pushtet ka pasur gjithmonë akte të rëndësishme që e kanë bindur BE-në për të ecur përpara.

Kështu ndodhi në vitin 2006 kur u miratua MSA-ja, kështu ka ndodhur në vitin 2008 kur na dhanë anëtarësimin në NATO, kur ne aplikuar më pas për anëtarësim në BE, kur dorëzuam përgjigjet për të gjitha pyetjet që na bëri BE-ja derisa jua bëmë gati që të merrnit pas rotacionit paqësor politik me zgjedhje të organizuara në mënyrë demokratike. Në vitin 2014 Shqipërisë iu dha statusi i vendit kandidat. Keni 5 vjet që e keni dërguar në stanjacion, sepse nuk ka qenë koncepti juaj që të bëni një politikë në favor të shqiptarëve, por ka qenë një politikë në favor të kriminelëve.

Zoti Manja, derisa deviza juaj si maxhorancë është: “Trafikantë të botës bashkohuni në Shqipëri!”. Me këtë po mbani sot peng integrimin e Shqipërisë në BE. Është shumë e thjeshtë Edi Rama në vitin 2013 bëri paktin, madje e bëri më herët që në vitin 2011, kriminelët që sulmonin institucionet me urdhër të Edi Ramës, nën udhëheqjen e Saimir Tahirit, por paktin final e bëri në vitin 2013 me këta kriminelë. Këtyre kriminelëve filloi t’u kthente menjëherë borxhin, provën e keni, jua thotë Guardia di Finanza italiane. Habilajt e Saimir Tahirit në shtatorin e vitit 2013, trafikonin 1,2 tonë drogë në Itali, thyenin menjëherë rekord, sepse kishin vizonin e qartë të Edi Ramës dhe kishin organizimin, mbrojtjen e Saimir Tahirit. “Trafikantë të të gjithë botës mblihduni në Shqipëri!”. Sot kanë protektorin me hyqmin e Edi Ramës Fatmir Xhafajn që nga ana tjetër është edhe arkitekti i dështimit epokal të sistemit të drejtësisë. Sot Shqipëria nuk ka sistem drejtësie. Askush nuk do të mendonte që në vitin 2008 kur Shqipëria u bë anëtare e NATO-s, ku kriteret për ne ishin kryesisht politike, 10 vjet më pas në Shqipëri do të kishte rënë koncepti bazë i shtetit të së drejtës. Sot nuk ka sistem drejtësie. Atë që Shqipëria nuk e ka pasur 100 vjet më përpara. Ende në fillimet tona, si shtet ne kishim sistem drejtësie. Këtë keni arritur ju sot.

Zoti Manja, nuk ka sistem drejtësie. Para pak ditësh u kap 2,5 tonë drogë në Itali. Sot kryetari i Komisionit të Ligjeve, thotë: “Shumë mirë që është kapur”.

**Ulsi Manja**- Pse, si të them?

**Oerd Bylykbashi** - 2,5 tonë ikin nga Shqipëria, nuk kapen këtu, por kapen në Itali. Nuk ju vjen turp?!

**Ulsi Manja** - Si të na vijë turp?! Shyqyr që u kapën!

**Oerd Bylykbashi** - Unë di se Fatmir Xhafaj, ministri juaj i Brendshëm po i shkatërron bandat kriminale duke i numëruar, 3 janë në Durrës sot, i dërmoi, u trembën dhe ikën të gjitha. “Po na numëron Fatmir Xhafaj”. Janë zhdukur. Kaq janë në Shkodër, kaq janë në Fier, kaq në Elbasan. Ky është ministri juaj i Brendshëm dhe vazhdojnë të kapen 2,5 tonë drogë. Nesër nuk e

dimë sesa të tjera. Kjo është prova sesi kufijtë e Shqipërisë penetrohen nga krimi i organizuar me lejen tuaj, sa kohë që fiken radarët. Nuk ka drejtësi. Arrihet deri tek ajo pikë që hartohet ligji për një person, ligji që po hartoni për Teatrin Kombëtar, se si t'i jepni një subjekti, që në fakt është vetëm surrati përpara vjedhjes që i bëjnë pronës publike dhe interesit publik të shqiptarëve Edi Rama dhe Erion Veliaj. Bëni ligj për një person, nuk ka ndodhur kurrë më parë. Kjo po ndodh se nuk ka sistem drejtësie, nuk ka Gjykatë Kushtetuese.

Zoti Manja, sot ju jeni komod...

**Ulsi Manja** – Mund të vazhdoni derisa të vijë zoti Çuçi dhe të kalojmë në votim.

**Oerd Bylykbashi** - ...kur preferoni të zgjidhni midis hajdutërisë së truallit dhe artistëve, intelektualëve dhe elitës së kombit. Jeni brutalë, por jeni komod në hajdutërinë tuaj.

**Ulsi Manja** - Nuk ka drejtësi sistemi ku ke dhënë votën edhe ti. Unë ta kam thënë në sy se çfarë ke bërë në atë sistem drejtësie.

**Ulsi Manja** – Votën e dhe, pastaj se çfarë ke thënë, është gjë tjetër.

**Oerd Bylykbashi** – Kur them ti, ta them si kryetar i Komisionit të Ligjeve.

**Ulsi Manja**- Dakord, po votën e ke dhënë.

**Oerd Bylykbashi** – Zoti Manja, për fat të keq, në atë kohë nuk e dije se me atë që kishe votuar nuk do të merrje më pjesë në sistemin e drejtësisë.

**Ulsi Manja** - Se çfarë ke thënë mbrapa, atë nuk e di, por votën e ke dhënë.

**Oerd Bylykbashi** – Nuk ka sistem drejtësie. Ju kaloni një ligj që u vjedh pronën pronarëve, u vjedh paratë investitorëve. Ligji “Për banesat sociale” grabit në mënyrë antikushtetuese të drejtat e tyre. Ku do të ankohen ata? Nuk ka sistem drejtësie. Ku është Gjykata Kushtetuese që do t'i mbrojë? Ka vetëm Edi Rama, i cili ka vendosur ta bëjë këtë gjë.

Flet edhe për të vobektit. Nuk ka sistem drejtësie, po u heq ndihmën sociale të vobektëve, del në televizion dhe bën si bamirës. Nuk i vjen turp edhe pse është Kryeministër. Po ku do të ankohen ata, sepse nuk ka sistem drejtësie?!

Zoti Manja, do të më dëgjosh deri në fund, është respekti minimal që duhet t'i japim njëri-tjetrit!

Nuk ka sistem drejtësie, prandaj kuksianët sot janë ende në burg. Ata kërkojnë të shkojnë në shtëpitë e tyre, ndërkohë që Saimir Tahiri është jashtë.

Në fakt, Shqipëria një objektiv ka. Shpresën të gjithë shqiptarët për pak ditë e kanë që të marrin një vendim pozitiv për hapjen e negociatave. Analiza është shumë e thjeshtë. Në një

shtet ku media është totalisht e kapur nga Kryeministri, ekonomia është e kapur nga njerëzit e Kryeministrit, pushteti është i kapur nga kriminelët e Kryeministrit. Cili është ai shtet evropian, që pranon një Kryeministër bandit, si Arturo Ui- a, ta fusë te klubi i tij? Kjo është gjëma që ju po u bëni shqiptarëve. Deviza tuaj është “Trafikantë të të gjitha vendeve bashkohuni në Shqipëri, sepse këtu keni mbrojtjen e sigurt”, kurse marka juaj tregtare është “Krim i organizuar me mbrojtjen e shtetit” dhe me këto ju sot pengoni BE-në, dhe më pas thoni se po na pengojnë. Kush po ju pengon? Po pengoni veten.

Pyesni veten tuaj se sa prej jush këtu merren me trafikë droge apo kanë vëllezër e kushërinj që merren me trafikun e drogës. Kjo duhet t’ju vërë edhe përpara përgjegjësisë, kur vazhdoni me kokën në rërë dhe mbështesni këtë që ndodh.

Sigurisht që largimi i Fatmir Xhafajt nga ministër i Brendshëm nuk është test për Europën. Në fakt, në çdo rast ju turpëron ju, edhe kur rri, edhe nëse ikën, sepse ju e keni bërë atë turp, sepse edhe kur të iki Fatmir Xhafaj, sa kohë Edi Rama do ta zëvendësojë me një tjetër si Saimir Tahiri, shqiptarët nuk kanë për ta parë dritën e integritimit evropian.

Kështu që, zoti kryetar, për ta mbyllur, duhet të vëmë në axhendën tonë të diskutimit këtë çështje, që është interesi i shqiptarëve, i cili është shkëputja e politikës nga krimi, sepse përndryshe pronat do t’ju grabiten, do të futen në burg, trafiket e drogës do të vazhdojnë, do të dhunohen artistët e kushdo tjetër dhe çdo gjë e zezë do të ndodhë në Shqipëri, integrimin evropian do të shohim përherë e më larg, por shqiptarët këtë nuk jua falin.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Bylykbashi!

Në fakt, deviza jonë nuk është “Trafikantë të botës bashkohuni”, por “Shqiptarë bashkohuni” e kush i thotë vetes shqiptar, sot është ora për t’u bashkuar, se nesër do të jetë shumë vonë. Ky juaji është mesazhi më i keq që jepet nga salla e Komisionit të Ligjeve.

Të bashkohemi për integrimin, sepse kjo është ora e shqiptarëve. Nuk po them të bashkohemi, ashtu siç thotë opozita, sepse e kanë vendosur shqiptarët atë, këtu nuk rrëzohet Kryeministri dhe maxhoranca me fjalime, por rrëzohet me numra, rrëzohet me votë dhe vota hidhet çdo 4 vjet, kur ka zgjedhje dhe atje e kemi sheshin, por deviza jonë nuk është “Trafikantë të botës, bashkohuni”, se ky është sinjal shumë negativ, që del nga opozita dhe nga ky komision. Deviza jonë është “Shqiptarë bashkohuni”, sepse është ora integritimit dhe nesër do të jetë vonë. Kjo është thirrja për të dy palët, se shqiptarë jemi gjithsesi edhe ju, edhe ne. Edhe ju përfaqësoni popullin opozitar edhe ne përfaqësojmë shumicën e shqiptarëve.

Gjithsesi, ky është qëndrimi juaj si opozitë dhe nuk keni pse na merrni leje ne për këtë qëndrime që mbani, në fund të fundit, por do të vijë një ditë që do të japim llogari para qytetarëve shqiptarë...

*(Diskutime pa mikrofon)*

... por ne mezi u futëm në zgjedhje, tani ju sapo mbaruam zgjedhjet, thoni se duam përsëri zgjedhje. Ky është halli me ju: mezi ju fusin në zgjedhje dhe pastaj, sa mbarojnë doni përsëri.

Gjithsesi, në bazë të nenit 31 të Rregullores, vazhdojmë me rendin e ditës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.06.2018, ora 11:30

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e korigjimit të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për huan e politikës së zhvillimit të sektorit financiar”. (*Komision për dhënie mendimi*)

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Enkelejd Alibeaj, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Spartak Braho, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi Tyli, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka, Elena Xhina, Luçiano Boçi.

**Mungon:** Tom Doshi

Erjon Luçi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Tedi Bushaj – Specialist në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

**Ulsi Manja** - Pika e tretë e rendit të ditës është shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e korigjimit të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për huan e politikës së zhvillimit të sektorit financiar”.

Komisioni i Ligjeve është komision për dhënie mendimi dhe relator është kolegu Bashkim Fino.

Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë kanë konfirmuar pjesëmarrjen zoti Erjon Luçi, zëvendësministër dhe zoti Tedi Bushaj, specialist.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Kur përmenda nenin 31 të Rregullores, aty thuhet qartë se komisionet nuk mund të diskutojnë dhe të vendosin për çështje që nuk janë në rendin e ditës dhe unë në rendin e ditës këtë pikë kam. Kështu që, zoti Luçi, do t’ju lutesha të flisni shumë shkurt.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Do t’ju lutesha, jemi në sallën e Komisionit të Ligjeve. Ju keni gjithë të drejtën që ju jep Rregullorja që këto probleme t’i diskutoni ditën e enjte në seancë dhe të mos ndërprisni seancën. Këtu do të zbatojmë Rregulloren.

Zoti Luçi, dakord me projektligjin?

Dakord.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Zoti Fino, fjala për ju si relator.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Bashkim Fino** – Faleminderit!

Do të ma heqësh fjalën me dhunë?

*(Diskutime pa mikrofon)*

Për Rregulloren kam shumë respekt... unë jam relator... më është dhënë fjala...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Të dëgjova me qetësi të madhe edhe ty, edhe kolegun tënd, tani m’u dha fjala...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Po pse ma pret fjalën? Po më lër të mbaroj dhe fol pas meje...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po pra, po mbaj qetësi, që të vazhdoj unë!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Mund të vazhdosh për projektligjin, pastaj ia japim fjalën zotit Alibeaj.

**Enkelejd Alibeaj** – Hë pra, më në fund!

**Ulsi Manja** – Kur të mbarojë zoti Fino.

**Enkelejd Alibeaj** – Jo, jo, tani!

**Ulsi Manja** – Tani jo, more zotëri! S'mund t'ia marrësh fjalën atij, se s'është etike njëherë.

**Enkelejd Alibeaj** – Si s'është etike?

**Ulsi Manja** – Ia kam dhënë fjalën përpara.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Po. Mund të vazhdoni me projektligjin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ai mund të vazhdojë të flasë me vete. Ju mund të vazhdoni me projektligjin.

**Enkelejd Alibeaj** – Rregullorja është e vetmja gjë që i ndan gjërat në këtë pikë. E kam kërkuar fjalën për procedurë, do të flas për procedurë.

**Ulsi Manja** – Ia kam dhënë fjalën zotit Fino më përpara.

**Enkelejd Alibeaj** – Po ta kam kërkuar fjalën përpara.

**Bashkim Fino** – Çfarë do të flasësh ti? Ja do të flasësh në zbatim të kalendarit të punimeve. Çfarë do të flasësh?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi dhe korrigjimi i një marrëveshjeje, që ka bërë Republika e Shqipërisë me Bankën Botërore...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flamur Noka** – Të kërkosh fjalën për procedurë e të mos ta japin!

O Flamur, një sekondë, se jam duke folur unë!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Propozimi ka ardhur nga Banka Botërore dhe synon të korrigjojë një lapsus të Bankës Botërore...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Shlyerja e huasë është 15 mars – 15 shtator. 2, 08 shuma e kështit të shprehur.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*



Duhet vendosur në këtë projektligj për shkak të lapsusit që ka bërë Banka Botërore, që 15 mars – 15 shtatori i 2048-ës, i fundit të vitit, i kështit të fundit, duhet të jetë 2, 24 %. Kjo është bërë me marrëveshje dhe nuk është firmosur. Unë mendoj që këtë lapsus ta kalojmë, pra të themi se më 15 mars – 18 shtator 2048, kësti i fundit i shprehur të jetë 2, 24 %. Shpresoj të kalojë dhe të miratohet.

Faleminderit, kryetar!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Ka pyetje për projektligjin?

**Enkelejd Alibeaj** – Dua fjalën për procedurë tani. Do ta hedhësh në votë tani e do të ikësh me vrap?

**Ulsi Manja** – Diskutime për projektligjin?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Enkelejd Alibeaj** – Për procedurë.

**Ulsi Manja** – Jo për procedurë, por diskutim për projektligjin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pyetje mund të bësh.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Veliaj ka kërkuar fjalën për pyetje.

**Astrit Veliaj** – Ka pesë vjet që opozita akuzon këtë maxhorancë për krim të organizuar, korrupsion dhe lidhjen e pushtetarëve me drogën. A ka të vërtetë këtu?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, kjo është pyetje: ka të vërtetë këtu?

Sigurisht që ka një të vërtetë, e cila ndodhet në ndërgjegjen tuaj, në ndërgjegjen tonë, në ndërgjegjen e familjarëve tuaj, në ndërgjegjen e opinionit publik, të medias. Ka një të vërtetë, të cilën nuk mund ta ndryshojë asnjë laborator e asnjë aktor. Është ajo ndërgjegje që nuk mund të ndryshohet, sepse bota dhe sistemi njerëzor është ndërtuar mbi disa parime, të cilat nuk të lejojnë të ndryshosh të vërtetën. E vërteta ka tre aktorë: ata që akuzojnë, ata që nuk e pranojnë të vërtetën.

**Ulsi Manja** – Zoti Veliaj, pyetjen, pyetjen. A do përgjigje për pyetjen?

**Astrit Veliaj** – Këtu ka një gjë të madhe, se populli po largohet...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – E kërkoi fjalën për pyetje.

**Astrit Veliaj** – Po i bëj të dyja bashkë.

**Ulsi Manja** – Pyetje e diskutim për projektligjin?

**Astrit Veliaj** – Kombi po braktiset, qytetet po kthehen në qytete-fantazma. Po t’i shohësh, disa qytete po braktisen me lagje. Kombi po braktiset nga rinia. Rinia është shpresë, është jetë, është garanci se ky vend ka një të ardhme. Mungesa e rinisë, e një rinie të papunësuar, të paarsimuar, janë shenjat e varfërisë e të falimentimit.

**Ulsi Manja** – Zoti Veliaj, ju lutem merruni me projektligjin!

**Astrit Veliaj** – Janë të dyja bashkë.

**Ulsi Manja** – S’janë të dyja bashkë, sepse je jashtë rendit të ditës.

**Astrit Veliaj** – Po i bëj të dyja bashkë. Me një vend ku gjykatat nuk japin drejtësi, një mjekësi ku nuk ka humanizëm, një arsim ku nuk ka cilësi, vendi duhet braktisur...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ne mund ta bëjmë edhe me zhurmues, por mua nuk më pëlqen ky lloj komunikimi....

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ja, të mbarojë zoti Veliaj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutemi, përfundojeni fjalën. Zoti Fino, të lutem, për procedurë.

**Bashkim Fino** – Për procedurë.

... kur kemi kaluar projektligjin e marrëveshjes së Bankës Botërore me Republikën e Shqipërisë, për një lapsus që është bërë në të kaluarën. Të lutem shumë, brenda kësaj gjëje, mbaro me projektligjin në fjalë. Kemi edhe çështje tjetër. në qoftë se duan ta marrin prapë fjalën për procedurë, jepua, por mos na e ngatërro procedurën me projektligjin në fjalë. jemi në procesin e votimit të projektligjit. Duam të bëjmë pyetje? Unë kisha shumë dëshirë të dëgjoja ndonjë pyetje për projektligjin, por nuk zgjova pyetje. Kështu, unë mendoj të kalojmë në votimin e projektligjit. Pastaj jepua sa të duash fjalën për procedurë.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Hedhim në votim në parim projektligjin...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

“Për ratifikimin e korigjimit të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për huan e politikës së zhvillimit të sektorit financiar”.

Kush është dakord në parim?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet në parim!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Neni 1. Kush është pro?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kush është pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Neni 2. Kush është pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka. Miratohet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kush është dakord në tërësi me projektligjin “Për ratifikimin e korigjimit të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për huan e politikës së zhvillimit të sektorit financiar”?

Kush është pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet në tërësi ky projektligj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.06.2018, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2017”.

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Enkelejd Alibeaj, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Spartak Braho, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi Tyli, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka, Elena Xhina, Luçiano Boçi.

**Mungon:** Tom Doshi

Erjon Luçi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Tedi Bushaj – Specialist në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

**Ulsi Manja** - Kalojmë në pikën 4 të rendit të ditës:

“Miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2017”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Noka, të lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Relatore është kolegja Elena Xhina.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Teksti i dakordësuar i rezolutës është përpara. E keni mbi tavolinë. E ka kërkuar fjalën, po pse ajo që quhet qeveri ose maxhorancë ka si mision të shtyjë ditët?

**Ulsi Manja**-Ju lutem, respektoni radhën! Në mulli ka radhë.

**Enkelejd Alibeaj** – Ju lutem, a mund të flas unë dhe të tregoj mullixhiun.

Pse fusni shpirtin në gjynah për gjëra që nuk i keni bërë?

Për gjëra që janë fare të thjeshta këtu kërkohet gjëja më e thjeshtë.

Për procedurë duhet të flasin deputetët. Kanë dëshirë të madhe të diskutojnë për këtë gjë, sepse kanë detyrim ndaj publikut. Ju pse keni frikë, pse doni të ikni me vrap? Pse i miratoni kështu?

**Ulsi Manja**– Sepse nuk kemi kohë, sepse jemi me agjendë integrimi. Ne punojmë për çeljen e negociatave, nuk kemi kohë të humbim. A e kuptoni këtë, apo jo? Ju jeni në pritje të hapjes së kampionatit botëror me datë 15 dhe doni ta shtyni kohën. Ne jemi me agjendë integrimi. Me ose pa ju do të çelen negociatat.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Enkelejd Alibeaj**– Duhet të flasim për çështje të rëndësishme. Ty mund të të vijë për të qeshur, ti nuk e ndien. Ti je në një barkë, e cila është duke marrë ujë nga dita në ditë dhe shumë shpejt do të mbytet, por shqiptarët nuk duhet të vijnë pas fatit tuaj të zi. Jepini fjalën deputetëve të opozitës të flasin për çështje që shqiptarët duan të dëgjojnë. Pastaj për të votuar mblidhuni në një sallë dhe votoni siç keni bërë, sepse numrat këto janë, por fjalën e lirë, meqë opozita për punë të saj ka fjalën, mos ia hiqni. Pse ju dhemb pse ju vret kaq shumë? Të kanë kërkuar fjalën deputetët e opozitës. A mundet që për procedurë për nenin 26, 31, dhe 77 jepi mundësinë të flasin. Dhe ju lutem, të mos ikni!

**Ulsi Manja** – Patjetër! Ju mund të vazhdoni, me modelin e seancës plenare mund të vazhdoni edhe pa ne, nuk është problem kjo punë.

Për procedurë fjalën e ka kërkuar zoti Hyseni.

**Dhurata Çupi** – Zoti Hyseni e kërkoj fjalën pas meje.

**Alket Hyseni**- Unë e kam kërkuar që në fillim fjalën.

Një nga kolegët e mi të opozitës është edhe anëtar i Sekretariatit të Procedurave dhe Votimit dhe e di shumë mirë se cila është procedura, dhe çfarë hapësire ka procedura, prandaj, ju lutem, të mos luajmë me këtë fjalë, sepse dëgjojnë shqiptarët dhe thonë se po u bëka nami dhe po shkelet e drejta opozitës. Procedura ka një minutazh. Ju zotëri, si anëtar i sekretariatit e keni shkelur i pari me të dy këmbët. Procedura ka një minutazh, a e respektuat? Jo, nuk e respektuat. Ne mund të lejonim këdo të fliste për procedurë nga anëtarët e komisionit, kurse kolegët e tjerë janë të mirëpritur të marrin pjesë në diskutime.

Unë mendoj se shqiptarët nuk kanë nevojë të dëgjojnë procedurat tuaja, sepse ju me procedurë iu shmangët edhe hetimit penal, ju procedurën e keni shumë të qartë, por shqiptarët duan të dinë se çfarë ligjesh do të miratojnë në të mirën e tyre, duan të dinë se çfarë hapash konkretë duhen bërë drejt integritetit në Bashkimin Europian. Ndërkohë që qeveria punon 24 orë ju shkoni dhe ... 24 orë. Shqiptarët këtë e dinë. Ju mund të flisni sa të doni, por unë prisja që zoti Bylykbashi ta ngrinte pak pjacën e diskutimit, nuk e ngriti dot as ai as ndonjë tjetër, sepse ju ua matin sasinë e baltës që hidhni.

Zoti, kryetar, të vazhdojmë me procedurën tonë. Nuk ka procedurë siç thonë këto. Kemi pikat e rendit të ditës, po të duan të diskutojnë dhe pikat e rendit të ditës, ju lutem, mos ia jep fjalën kot.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Dhurata Çupi** – Zoti Manja, kemi tashmë 4 javë që kërkojmë që Komisionin e Ligjeve ta ktheni në hullinë e legjitimitetit. Në këtë komision në pozicionin tuaj para jush ka qenë vëllai i Agron Xhafajt, Fatmir Xhafajt dhe që është ministër i Brendshëm sot. Në këtë komision ka ndodhur ngjarja më tronditëse. Nuk ka ndodhur ndonjëherë në komisionet parlamentar në këto në 27 vjet të jetë trafikuar jo një shkresë, jo një ligj i thjeshtë, por është trafikuar Kodi i Procedurës Penale për të favorizuar vëllain e Fatmir Xhafajt. Prandaj jua kam kërkuar para 4 javëve dhe vazhdoj t'jua kërkojë që t'i ktheni legjitimitetin. Zoti Manja ju trashëgoni në atë pozicion atë të Fatmir Xhafajt, sot ministër i Brendshëm që ka favorizuar vëllain e tij që ishte i dënuar me 7 vjet e dy muaj për trafikim droge. Është ministër, por çdo ditë vazhdon të kapet në Itali ose vende kufitare

trafikim droge. Para Fatmir Xhafajt ishte një tjetër ministër, i cili sot është në gjykim për trafikim droge, i cili ka qenë anëtar i Komisionit të Ligjeve.

Prandaj, zoti Manja, ju duhet ë distancoheni, t'i kërkonti kryeministrit, dilni jashtë kufizimeve të partisë, dhe mos komprometoni figurën tuaj, por kërkojini kryeministrit ta largojë ministrinë Brendshëm, sepse atje qëndron edhe zgjidhja e negociimit me Bashkimin Europian. Që ju e doni Bashkimin Europian dhe opozita, që përfaqësohet nga Partia Demokratike, nuk e do Bashkimin Europian, vetëm ju mund ta besoni këtë. Ju mbase nënqeshni me vete, por kjo është të gajasen së qeshuri edhe fëmijët. Në 4 vjetët e para u justifikuat që bashkë me timonin keni instruktorin që i kishte fajet, tashmë keni një vit që timonin e keni ju dhe ju kanë ngelur gomat në baltë, sepse në baltë keni korrupsionin më të madh, balta ju ka zënë me drogën, balta ju ka zënë me heqjen e ndihmës ekonomike dhe varfërimin total, balta ju ka zënë me marrjen e pronave publike.

Pra, çdo ligj që vjen këtu është me një favor nga pas ose për një ministër, ose për një klient tuajin. Ju këtu miratoni heqjen e ndihmës ekonomike dhe nga ana tjetër miratoni t'u merren prona ish-pronarëve dhe t'u jepen klientëve tuaj; miratoni një ligj për koncesionet dhe nga ana tjetër koncesionin e merr klienti juaj, ndërkohë që raporti dhe materialet e KLSH-së çdo ditë dhe çdo muaj për të gjitha institucionet tuaja është katastrofike dhe tronditëse. Viti 2017 ishte viti me 820 milionë euro dëm ekonomik, viti 2018 është akoma më i rëndë, prisni dhe do ta shihni. Ju lutem, kthejini legjitimitetin Komisionit të Ligjeve, mos miratoni ligje për veten tuaj, mos miratoni ligje për të mbrojtur Fatmir Xhafajn dhe Saimir Tahirin, por miratoni ligje për shqiptarët.

Është pabesueshme, është qesharake që ju kërkonti të shkoni në Bashkimin Europian, ndërsa ne si Parti Demokratike, që lindëm me sytë nga Europa, nuk e duam Europën. Ju, të mbytur në korrupsion, të mbytur në drogë dhe në trafikim njiheni si qeveria më e keqe në 27 vjet, njiheni si qeveria, sepse nuk guxon të bësh një dialog me çdo europian, sepse ata thonë se ju shqiptarët njiheni për trafik droge. Në çdo vend të Europës këtë vulë i keni vënë Shqipërisë, prandaj ktheni legjitimitetin, gjeni guximin, zoti Manja, nëse nuk jeni pjesë e trafikimit apo e Kodit të Procedurës Penale dhe e falsifikimit, largohuni dhe gjeni guximin të ikni. Kërkojini Kryeministrit largimin e Fatmir Xhafajt.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Çupi!

Në fakt, Komisioni i Ligjeve është tribuna e mendimit të lirë, prandaj jo më kot sot ka ardhur këtu i gjithë grupi parlamentar i Partisë Demokratike, sepse kjo është tribuna ku keni

mundësinë të shpreheni lirshëm. Unë e di që ju të gjithë jeni të papunë, prandaj keni ardhur të gjithë sot këtu, por paraprakisht nënkryetarja të më kishte informuar dhe do ta kisha bërë rendin e ditës më të gjatë dhe të flisnit të gjithë me radhë...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Fjalën për procedurë e ka kërkuar profesor Tritan Shehu...

*(Diskutime për mikrofon)*

Për çfarë? Për rezolutën, për diskutim?

Ja, eksperiencia parlamentare!

Zoti Shehu, e ka kërkuar fjalën të diskutojë për projektrezolutën për veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017.

**Tritan Shehu** – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, ashtu siç e thatë ju, ky është komisioni më demokratik, por kjo për faktin se e drejtoni ju dhe unë për këtë arsye kam ardhur në këtë komision për të ngritur disa çështje për Avokatin e Popullit.

Çështja e Avokatit të Popullit dhe funksioni i tij janë shumë të rëndësishme në një vend demokratik. Janë shumë të rëndësishme, sepse lidhen me demokracinë e vendit, me të drejtat e njeriut, me luftën kundër krimit dhe kundër trafikëve. Unë dua të ngre disa shqetësime që kanë të bëjnë pikërisht me këto elemente, të cilat nuk kanë zënë atë vend që duhej të zinin, jo vetëm në aktivitetin e institucioneve shqiptare, por janë kthyer pa dyshim kanceri, gangrena dhe shkatërrimi i këtij vendi.

Zoti kryetar, jua kam thënë edhe herë të tjera, jua kam thënë edhe para disa vjetësh, kur Shqipëria po mbushej me kanabis, se Shqipëria po binte në peshën e krimit. Fatkeqësisht sot në Shqipëri po instalohet diktatura e krimit. Dikujt kjo fjalë ose ky term mund t'i duket i rëndë, por kjo është e vërteta. Kjo gjë ka filluar të ndodhë që kur shteti stimuloi krimin për ta mbushur vendin me kanabis dhe me trafikë, pa dyshim më pas u dominua dhe ra pre e këtij krimi. Diktatura më e egër, që rrethohet nga gjëja më e egër, është pa dyshim diktatura e krimit, diktatura më shkatërruese për një vend, për të ardhmen e një vendi dhe të një populli dhe është pengesa kryesore, thelbësore në rrugën tonë të integritimit evropian. Është pengesa më e madhe që ne kemi, pikërisht për realizimin e aspiratës sonë që nga viti 1990 për ta bërë Shqipërinë si e gjithë Europa. Kjo është diktatura e krimit, zoti kryetar, ky është problemi më i madh që ka Shqipëria, e cila kërkon ndryshime të mëdha në Shqipëri.



Kjo nuk është aq e thjeshtë që të kalohet me dorëheqjen e një ministri, por çështja është rrëzimi dhe largimi i një qeverisjeje të korruptuar, të kriminalizuar dhe të institucioneve që janë të lidhura me krimin, që pa dyshim e kanë krijuar këtë gjë, duke vënë në rrezik të ardhmen të qytetarëve, duke bërë që mijëra e mijëra qytetarë të largohen, gjë që fatkeqësisht edhe Avokati i Popullit nuk e ka pasqyruar ndonjëherë në materialet e tij. Po jua them këtë jo thjesht për të qenë brenda pikës së rendit të ditës, por po jua them si diçka të vërtetë dhe të madhe, që nuk e kemi dëgjuar.

Ky është një ndër problemet kryesore që ne duhet ta ngremë sot këtu në komision, duke kërkuar pikërisht që gjërat të etiketohen me emrin e tyre, duke thënë atë që është, gjë që e kam përsëritur disa herë, diktatura e krimit. Nuk jam duke e ekzagjeruar, sepse kur institucionet e shtetit stimulohen dhe mbjellin drogën, marrin nga 10-15 mijë euro për çdo bimë kanabis, ia çojnë shefit të komisaritit dhe ai i çon në qendër, terrorizojnë fshatarët për kanabisin që kanë mbjellë, sepse i kanë të regjistruara dhe i dinë se ku i kanë...

Shikojeni pak, kjo pa dyshim është diktatura e krimit, nuk ka gjë tjetër diktatura e krimit. Ata njerëz i emërojmë prapë në ato detyra dhe në ato vende, të cilat i kanë pasur para 3-4 vjetësh, pa iu cekur asnjë fije floku. Pa dyshim kjo është diktatura e krimit se vjen nga lart, krimi vjen nga lart dhe kjo nuk zgjidhet me një lëvizje të vogël dhe me një tërheqje, por zgjidhet me atë që të gjithë bashkë duhet t'i kundërvihemi diktaturës së krimit, sepse nuk ka gjë më të egër se ajo për një vend.

Zoti kryetar, dua të ndaj edhe diçka tjetër, duke tërhequr vëmendjen e medieeve dhe të kolegëve. Diktatura e krimit po krijon një tjetër situatë tragjike për Shqipërinë. Nuk është e vërtetë që nuk ka projekte për ta mbushur Shqipërinë me refugjatë nga vende të ndryshme. Ka! E tha “Le Monde”, e ka thënë gazeta amerikane prestigjioze, dje e tha Kryeministri i Bullgarisë, të cilët lidhen me ish-terroristë të ISIS-it, lidhen me emigrantë, të papranueshëm për Bashkimin Europian. Cilët janë këta?

Do të bëj një paralajmërim edhe për komunitetin ndërkombëtar. Kjo gjë do të bëjë, pa dyshim, që të bien pre e diktaturës së krimit, e grupeve kriminale dhe grupeve mafiozë. Të jeni të bindur që do të krijojë një korridor të vazhdueshëm Durrës-Itali dhe një Otranto të mbushur me viktima dhe kufoma të nëndetshme. Kjo gjë po nxitet nga ata, të cilët duan destabilizimin në vendin tonë dhe në Ballkan, që ndodhen brenda dhe jashtë Shqipërisë. Po, ka edhe jashtë Shqipërisë të tillë! Doni të dini cilët janë? Ata duan të krijojnë destabilizim në rajon, Ballkan dhe në Shqipëri.

Të lidhur me mafien, me grupet e grimit, me diktaturën e krimit, e cila do të krijojë rrugë trafiqesh, fitime miliardësh. Ky është një rrezik i madh, jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për Italinë. Miqtë italianë duhet ta kuptojnë qartë këtë gjë. Ky është një rrezik i madh edhe për Greqinë, edhe për Europën në tërësi, ndaj mendoj se këto janë elementet që duhet të ngremë edhe kur të shikojmë të tjera rezoluta si ajo e Avokatit të Popullit, sepse bien ndesh me të drejtat e njeriut, me demokracinë, me vlerat dhe me të ardhmen e Shqipërisë.

Faleminderit, zoti kryetar!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Shehu!

Ju quheni ekspert i politikës së jashtme, por të jeni i bindur, që edhe ne si shumicë, jemi po aq atdhetarë saç jeni edhe ju, sepse tek atdhedashuria dhe çështjet e Shqipërisë nuk besoj se ndahemi.

Nuk më vjen mirë për këtë kampanë paniku, që sapo thatë në Komisionin e Ligjeve. Këto çështje mund t'i ngrini shumë mirë në Komisionin për Çështjet e Politikës së Jashtme, aty ku edhe jeni anëtar. Po të doni, mund të thërrisni edhe një seancë të posaçme në atë komision, të kërkonti të jetë prezent edhe ministri i Jashtëm, pse jo, edhe në seancë plenare mund të kërkonti të vijë Kryeministri që t'u japë përgjigje shqetësimeve që keni.

Zonja Xhina, për rezolutën, ju lutem!

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Albana Vokshi** - Ulsi, të lutem duhet të më japësh fjalën për procedurë.

**Ulsi Manja** – Nuk ka leje!

**Albana Vokshi** – S'ka leje? Demokracia qenka sheshit në këtë komision!

*(Diskutim i disa personave pa mikrofon)*

**Albana Vokshi** – Ulsi, kam marrë fjalën për procedurë!

**Ulsi Manja** – Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet projektrezoluta për vlerësim e veprimtarisë...

*(Diskutim i disa personave pa mikrofon)*

Këtu e mbyllim mbledhjen e komisionit për ditën e sotme!

Mbledhja e radhës së bashku me rendin e ditës do t'ju njoftohet nga sekretarja e komisionit!

*(Diskutim i disa personave pa mikrofon)*

Ju mund ta vazhdoni mbledhjen e komisionit!

## **MBYLLET MBLEDHJA**